



BASHKIA
TIRANË

URDHËR

Nr. 29688, datë 9.8 2017

PËR MARRJEN E MASAVE PËR KONTROLLIN E PARKIMIT TË MJETEVE NË ZONAT DHE NËNZONAT E DESTINUARA PËR PARKIM NË ADMINISTRIM TË TIRANA PARKING

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 29, pika 4, nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës" (i ndryshuar); vendimit nr. 49, datë 11. 11. 2015 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit dhe nënzonave të destinuara për parkim, si dhe tarifave të shërbimit të parkimit të administruara nga Bashkia e Tiranës" (i ndryshuar); me qëllim kontrollin e parkimit të mjeteve në zonat dhe nënzonat e destinuara për parkim në administrim të Tirana Parking,

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave për ushtrimin e kontrollit të parkimit të mjeteve në zonat dhe nënzonat e destinuara për parkim në administrim të Tirana Parking.
2. Ky kontroll konsiston në zbatimin e kontrollit të tarifës së paguar për sasinë e kohës të qëndrimit në parkim, të caktuar sipas zonave dhe nënzonave të destinuara për parkim, në administrim të Tirana Parking.
3. Gjatë ushtrimit të kontrollit me objektin e përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri, shkelësi ndëshkohet me masë administrative gjobë, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor dhe legjislacionit në fuqi, në rastet kur konstatohet se:
 - a. Ka tejkallim të kohës qëndrimit në parkim, përtej kohës për të cilën është paguar tarifa;
 - b. Mjeti është parkuar pa paguar tarifën e parkimit;
 - c. Mjeti nuk është parkuar në zonën e përcaktuar në kartën e rezidentit;
4. Inspektimi dhe ushtrimi i kontrollit sipas këtij urdhri, kryhet nga ana e Policisë Bashkiake, sipas listës së rrugëve bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij dhe mbikëqyret nga Tirana Parking.
5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Policia Bashkiake dhe Tirana Parking.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ERION VELIAJ

